


# TaxNews

Prill 2019  
April 2019



**Deloitte.**

## **I. Ndryshime dhe shtesa në VKM për dispozitat zbatuese të Ligjit për TVSH**

Është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 25.03.2019 dhe ka hyrë në fuqi Vendimi nr. 145, datë 20.03.2019. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij vendimi janë evidentuar veçmas kodet tarifore përkatëse të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe inputeve bujqësore të cilat janë të përjashtuara nga TVSH-ja që prej 1 janar 2019.

## **II. Ndryshime në Udhëzimin për Tatimin mbi të Ardhurat**

Në Fletoren Zyrtare nr. 35, datë 21.03.2019 është publikuar Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 12, datë 15.03.2019 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 'Për tatimin mbi të ardhurat'", i ndryshuar, i cili risjell formatin e përditësuar të deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe deklaratës mujore të tatimit të mbajtur në burim, ku janë reflektuar respektivisht normat e ndryshme tatimore të tatimit mbi fitimin dhe ndryshime në zërat e tatueshëm për qëllime të tatimit në burim.

## **III. Ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin për Procedurat Tatimore**

Është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 35, datë 21.03.2019 dhe ka hyrë në fuqi Udhëzimi nr. 10, datë 15.03.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar.

## **I. Amendments and additions to the DCM on implementing provisions of the Law on VAT**

Decision no. 145, dated 20.03.2019 on some additions and amendments to the Decision no. 953, dated 29.12.2014 of the Council of Ministers, "On implementing provisions of the Law no. 92/2014, 'On Value Added Tax in the Republic of Albania'", as amended, has been published in the Official Gazette no. 36, dated 25.03.2019 and entered in force.

Through this decision are evidenced separately the respective tariff codes for machinery and agricultural equipment and agricultural inputs that are exempt from VAT since 1<sup>st</sup> of January 2019.

## **II. Amendments to the Instruction on Income Tax**

In the Official Gazette no. 35, dated 21.03.2019 has been published the Instruction of the Minister of Finance and Economy no. 12, dated 15.03.2019 "On some amendments to the Instruction no. 5, dated 30.01.2006 'On income tax'", as amended, presenting updated formats of the annual corporate income tax return and the monthly withholding tax return that reflect respectively changes of tax rates and changes of the taxable items for withholding tax purposes.

## **III. Amendments and additions to the Instruction on Tax Procedures**

Instruction no. 10, dated 15.03.2019 "On some additions and amendments to the Instruction no. 24, dated 02.09.2008 'On tax procedures in the Republic of Albania'", as amended, has been published in the Official Gazette no. 35, dated 21.03.2019 and entered in force.

Më poshtë kemi përmbledhur dispozitat më relevante nga një sërë shtesash dhe ndryshimesh që janë reflektuar në Udhëzimin për Proçedurat Tatimore:

- **Regjistrimi i personave fizikë**

Janë reflektuar në udhëzim ndryshimet në lidhje me regjistrimin e personave fizikë. Një individ mund të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik tregtar vetëm një herë dhe pajiset me një numër unik të vetëm identifikimi (NUIS/NIPT).

Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit, që është i ndryshëm nga adresa kryesore, personi fizik pajiset me një certifikatë me NUIS/NIPT të njëjtë, por me numër serial të ndryshëm.

Individët të cilët janë të pajisur me disa numra unikë identifikimi të tatimpaguesit duhet të mbyllin NIPT-et e tjera dhe të mbajnë vetëm një NIPT kryesor brenda datës 31.08.2019 ose në rast të kundërt, administrata do të kryejë vlerësim alternativ.

- **Pezullimi i aktivitetit**

QKB do të pranojë pezullimin e aktivitetit vetëm në rastet kur subjekti/tatimpaguesi ka paguar të gjitha detyrimet tatimore në momentin e aplikimit. QKB kryen verifikimet e detyrimeve tatimore dhe vetëm pasi është verifikuar më parë situata e detyrimeve tatimore miratohet pezullimi i aktivitetit.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se subjektet/tatimpaguesit që kanë lidhur marrëveshje për pagesë më këste të detyrimeve tatimore, nuk mund të pezullojnë veprimtarinë ekonomike.

Herein below we have summarized the most relevant provisions from a number of additions and amendments that are reflected in the Instruction on Tax Procedures:

- **Registration of an entrepreneur**

The instruction reflects the amendments regarding the registration of entrepreneurs (commercial natural persons). An individual can be registered to the National Business Center as a commercial physical person only once and be equipped with one unique number of identification (NUIS/NIPT).

For every other location in which exercises its activity, different from the main address, the physical person is equipped with a certificate with the same NUIS/NIPT but with a different serial number.

Individuals equipped with several unique taxpayers' identification number must deregister the other NIPTs and keep only one main NIPT within 31.08.2019 otherwise, the tax administration will perform alternative assessment.

- **Suspension of activity**

The NBC will accept the suspension of the activity only in the cases where the entity/taxpayer has paid all tax liabilities in the moment of application. The NBC performs the verification of the tax liabilities and only after verifying the situation of the tax liabilities can be approved the suspension of the activity.

It is important to consider that entities/taxpayers who have entered into agreements for payment on installments of tax liabilities may not suspend their economic activity.

- **Transaksionet me personat me status pasiv**

Reflektohen në udhëzim penalitetet e zbatueshme në lidhje me transaksionet e kryera nga personat që rezultojnë pasivë në datën e transaksionit.

Këto transaksione do të konsiderohen shkelje administrative dhe penalizohen si në vijim:

- a. Për shitësin që është në regjistrin pasiv, kalohet në status aktiv dhe bëhet vlerësim tatimor dhe dënohet për evazion tatimor;

- b. Për blerësin mos-njohje e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Me përjashtim të subjekteve që veprojnë në fushën e telekomunikacionit, energjisë dhe ujit për konsumatorët finalë, sigurimeve si dhe kontratave afatgjata leasing, transaksionet e kryera nga personat aktivë me persona në regjistrin pasiv janë shkelje administrative dhe dënohen si vijon:

- a. Shitësi aktiv dënohet me 10,000 lekë gjobë;

- b. Blerësi pasiv kalon në status aktiv dhe dënohet për evazion tatimor.

- **Çregjistrimi i tatimpaguesve/subjekteve**

Në udhëzim përcaktohet se personat juridikë dhe fizikë çregjistrohen nga regjistri administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë. Përjashtim përbëjnë rastet specifike të personave të tjerë të cilët fillimisht regjistrohen vetëm pranë administratës tatimore si përfaqësuesit tatimorë, ambulancat, njësitë e zbatimit të projekteve etj.

- **Transactions with taxpayers in passive registry**

The instruction reflects the applicable penalties regarding the transactions performed by taxpayers resulting with passive status in the date of transaction.

Such transactions will be considered as administrative violations and will be penalized as follows:

- a. The seller in the passive register is transferred to the active register and a tax assessment is performed along with the application of penalties for tax evasion;

- b. The buyer is not allowed to deduct input VAT and the related expense.

With the exception of entities operating in the telecommunications, energy and water supplying sectors for final consumers, insurance and long-term leasing contracts, transactions carried out by active persons with persons in the passive register are administrative violations and are punishable as follows:

- a. The active seller is penalized by an ALL 10,000 penalty;

- b. The passive buyer is transferred to the active register and is penalized for tax evasion.

- **Deregistration of taxpayers/entities**

The instruction provides that legal and physical persons are deregistered from the tax administration's register only after their deregistration at the National Business Center and/or the court. The exception are the specific cases of other persons who initially register only with the tax administration such as tax representatives, ambulant traders, project implementation units, etc.

Rregulla, procedura dhe afate më të qarta dhe të detajuara janë reflektuar tashmë në dispozitat e udhëzimit për çregjistrimin e:

- Personave fizikë dhe juridikë të regjistruar në QKB;
- Shoqërive si pasoje e ri-organizimit të shoqërisë (bashkim/ndarje);
- Subjekteve të regjistruar në gjykatë;
- Subjekteve të regjistruar vetëm në administratën tatimore.

Vlen për tu theksuar se çregjistrimi i subjektit në QKB/ gjykatë apo administratë tatimore, nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.

- **Korrigjimi i deklaratave tatimore**  
Tashmë në udhëzim përcaktohet që tatimpaguesit kanë të drejtë për të korigjuar deklaratat tatimore brenda 36 muajve nga deklarimi i deklaratës fillestare sa herë që konstatojnë gabime në deklaram (më parë lejohej vetëm një herë brenda afatit).

Deklaratat nuk mund të korigjohen në ulje detyrimi kur kjo deklaratë është kontrolluar nga administrata tatimore.

- **Rregullat kundër shmangies tatimore**  
Udhëzimi detajon më tej rregullat kundër shmangies tatimore të parashikuara në nenin 71/2 të Ligjit për Procedurat Tatimore duke ilustruar pozicionin që pritet të mbajë administrata përmes disa rasteve tipike të transaksioneve që mund të jenë subjekt i rregullave anti-shmangie.

More detailed and clear rules, procedures and deadlines are already reflected in the provisions of the instruction for the deregistration of:

- Natural and legal persons registered to the NBC;
- Companies as a consequence of reorganization (merger/split);
- Entities registered to the court;
- Entities registered only to the tax administration.

It is worth pointing out that the deregistration of the entity at the NBC / court or tax administration does not eliminate unpaid tax obligations and does not prevent the tax administration from assessing or collecting with force the tax liabilities.

- **Correction of tax returns**  
It is now specified in the instruction that taxpayers are entitled to correct their tax returns within 36 months from the declaration of the initial return whenever they find errors in the respective returns (previously only allowed once within this timeframe).  
Tax returns cannot be corrected by lowering the tax liability when such returns have already been audited by the tax administration.

- **Anti avoidance rules**  
The instruction further explains the anti avoidance rules stipulated in article 71/2 of the law by illustrating the position expected to be held by the tax administration through some typical cases of transactions that may be subject to anti avoidance rules.

- **Rregullat e rimbursimit të TVSH-së**

Rimbursohen brenda 30 ditëve, por janë subjekt i analizës së riskut tatimpaguesit që nuk janë importues me risk zero (eksportues vlera e eksporteve të të cilit është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet), por i nënshtrohen regjimit të përpunimit aktiv ose janë eksportues, vlera e eksporteve të të cilëve përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së shitjeve, përfshirë eksportet.

- **Mbledhja me forcë e detyrimeve të tatimpaguesit**

Në kuadër të procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimeve të tatimpaguesit, një shtesë në udhëzimin për procedurat tatimore parashikon se urdhërblokimi i llogarive i dërgohet bankave tek të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi, ose administratori apo pronarët e shoqërisë tregtare kanë llogaritë e tyre, si dhe të gjitha bankave të tjera me seli në Republikën e Shqipërisë.

- **Procedura e ankimit administrativ**

Udhëzimi përcakton se edhe nëse ankimi dorëzohet pranë një organi jo-kompetent, afati i ankimit konsiderohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në afat pranë organit jo-kompetent.

- **VAT reimbursement rules**

Taxpayers that are not considered as zero risk exporters (exporters of which the amount of exports constitutes of more than 70% of the total amount of sales including exports) but are subject to the active processing regime or exporters with an amount of exports constituting more than 50% up to 70% of the sales amount (including exports), will be reimbursed within 30 days subject to the risk procedures.

- **Forced collection of taxpayers liabilities**

In the framework of procedures for forced collection of taxpayer liabilities, an addition to the Instruction on Tax Procedures provides that blocking orders are sent to banks to which the tax administration is aware that the taxpayer or the administrator or the owners of the company have their accounts, as well as all other banks resident in the Republic of Albania.

- **Administrative appeal procedure**

The instruction provides that even if the appeal is submitted to a non-competent body, the appeal deadline is considered as met if the request has been submitted within the deadline to the non-competent body.



Reflektohet edhe në udhëzim ndryshimi i një prej kushteve për të vazhduar me procedurën e ankimit sipas ligjit. Në situatat kur tatimpaguesit zgjedhin të vendosin një garanci bankare për detyrimet tatimore, garancia duhet të përfshijë tanimë vetëm shumën e detyrimit principal tatimor objekt ankimit dhe jo më kamatëvonesat e përlllogaritura.

Udhëzimi gjithashtu parashikon afatet për rastet e ankimeve që varen nga çështje të mëparshme duke theksuar se në raste të tilla, DAT ose KSHAT mund të nxjerrin vendime të përkohshme për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çështjes së mëparshme por jo më shumë se gjashtë muaj nga momenti i nisjes së pezullimit. Nëse kur përfundon ky afat, çështja e mëparshme mbetet ende e pazgjidhur, DAT ose KSHAT vijon me shqyrtimin e apelimit. Në rastet e pezullimit, nëse ende nëntë muaj pas dorëzimit të kërkesës fillestare, DAT apo KSHAT nuk kanë nxjerrë vendimin, ankimesi mund t'i drejtohet direkt gjykatës.

It is also reflected in the instruction the amendment of one of the conditions to proceed with the appeal procedure according to the law. In the cases where the taxpayers decide to put a bank guarantee for tax liabilities, the guarantee must include only the amount of the principal tax liability subject of appeal and not the calculated interests.

The instruction also defines the deadlines in the cases of appeal dependent from previous cases by stating that in such cases, the TAD or TARC may issue temporary decisions for the suspension of the procedure until resolved the previous case but not longer than six months from the start of the suspension. If, at the end of such deadline, the previous case is still unsolved, the TAD or TARC proceed with the examination of the appeal. In the cases of suspension, if still after nine months after the declaration of the initial request, the TAD or TARC have not issued the decision, the taxpayer can appeal directly to the court.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.